



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

PROJEKT VENDIM

Nr. ____ datë ____ / ____ 2025

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT TË BUXHETIT DHE VLERËSIMIN E
PËRGJITHSHËM FINANCIAR PËR PERIUDHËN JANAR-GUSHT 2025 ,BASHKIA PËRMET

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, Ligjin Nr 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjin Nr. 68/2017 “Per financat e vetqeverisjes vendore”,i ndryshuar, neni 48 “ Monitorimi dhe zbatimi i buxhetit vendor”, Ligji nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025” , Udhëzim nr.2 datë 24.01.2025 ‘Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025” Udhëzim nr.35 datë 29.12.2023 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetqeverisjes vendore”,Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë raportin e monitorimit të Buxhetit dhe vlerësimin e përgjithshëm financiar , për periudhën 8-mujore,viti 2025,për Bashkinë Përmet.
2. Ky vendim shpallet menjëherë dhe hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË
ALMA HOXHA

Alma
Hoxha

Digitally signed by Alma
Hoxha
Date: 2025.09.17
12:39:12 +02'00'



2.1Të pakësohen shpenzimet :

Në lekë

Strukturat	Programet	Kod Produkti	Kap	231 (investime)	Pershkrim
MNZ	AE135	P328AAA	01	4136000	Blerje mjeti zjarrfikës

2.2Të shtohen shpenzimet:

Në lekë

Strukturat	Programet	Kod Produkti	Kap	600 (paga)	601 (sigurime)	606 (transferta tek individe)	Pershkrim
MNZ	AE135	V328AAA	01	1200000	536000	2400000	Paga ,sigurime dhe psherblim per punonjesit

3.1Të pakësohen shpenzimet :

Në lekë

Strukturat	Programi	Kod Produkti	Kap	602 (shpenzime operative)	Pershkrim
Sporti	AD135	V813AAB	05	331000	Lidhje energjie dhe blerje materiale të nevojshme per realizimin e lidhjes për Pallatin e sportit

3.2Të shtohen shpenzimet :

Në lekë

Strukturat	Programi	Kod Produkti	Kap	600 (paga)	601 (sigurime)	602 (shpenzime operative)	Pershkrim
Perfshirja sociale	AC135	V043AAA	05	252000	79000		Projekti RIWET dhe Key people

4.1Të pakësohen shpenzimet :

Në lekë

Strukturat	Programi	Kod Produkti	Kap	602 (shpenzime operative)	Pershkrim
Kultura	AD135	V822AAA	05	500000	Maratona e Kenges popullore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PËRMET

RELACION
PËR
PROJEKT- VENDIMIN

PËR

**NJË SHITESË DHE DISA NDRYSHIME NË VKB NR. 107 DATË 18.12.2024 “ PËR MIRATIMIN E
BUXHETIT TË BASHKISË PËRMET VITI 2025”**

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin Nr. 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore", i ndryshuar, Ligjit nr.43/2016 "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë" VKM nr.775 datë 24.09.2010 "Për administrimin e financimeve të huaja", Udhëzimi nr.10 datë 12.07.2024 "Për rregjistrimin ,përdorimin,rakordimin,raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjes ndërkombëtare", Ligji 115/2024,"Për buxhetin e vitit 2025", Udhëzimit nr. 2 datë 24.01.2025 " për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", Akt marrëveshje nr.2990 datë 17.09.2025 me Këshillin e Qarkut "Për realizimin e Restaurim i Lapidarit" Ushtari i Panjohur", VKM nr.483 datë 02.09.2025" Për dhënie shpërblimi personelit të angazhuar në operacionet për shuarjen e zjarreve gjatë vitit 2025",për arsyet e mëposhtme ju parashtojme shtesën dhe ndryshimet :

Në zbatim të VKB nr.4 datë 02.02.2021 "Për miratimin e akt marrëveshjes midis këshillit të bashkisë përmet dhe Këshillit të Qarkut Gjirokastrë" është lidhur Akt marrëveshja nr.2990 datë 17.09.2025 me Këshillin e Qarkut "Për realizimin e Restaurim i Lapidarit" Ushtari i Panjohur",investim ky i financuar nga këshilli i Qarkut me financim që shtrihet në dy vite :4 000 000 lekë në vitin 2025 dhe 4 277801 lekë në vitin 2026.Bashkia Përmet sipas vendimeve të miratuara më herët nga Këshilli Bashkik mbulon oponencë,mbikqyrje,kolaudim në vlerën 230000 lekë.

1.1Të shtohet zëri i të ardhurave si më poshtë:

Grand nga një nivel qeverisje nga buxhet i pushtetit vendor në vlerën 4 000 000 lekë nga Këshilli i Qarkut

1.2Të shtohen shpenzimet në strukturën e mëposhtme:

Strukturat	Programi	Kod Produkti	Kap	231 (investime)	Përshkrim
Kultura	AD135	P822AAY	01	4000000	Bashkefinancim per Restaurim të Lapidarit “Ushtari i Panjohur”

Siç dihet edhe nga raportimet që janë kryer në Këshill në territorin e Bashkisë Përmet këtë vit ka pasur raste zjarresh. Pagesa e oreve shtesë për rastet e zjarreve për stafin e MZSH –së kërkon të rishpërndajmë fondet buxhetore pasi deri në fund të vitit lind nevoja për fond pagash e sigurimesh. Në zbatim të VKM-së nr.483 datë 02.09.2025” Për dhënie shpërblimi personelit të angazhuar në operacionet për shuarjen e zjarreve gjatë vitit 2025”,pika 9,specifikon që efektet financiare duhet të përballohen nga buxhetet e njësive të vetqëverisjes vendore.

Meqënëse gjatë vitit 2025 Bashkia përmet ka përfituar fonde për blerjen e një mjeti nga Emergjencat Civile sygjerojmë ndryshimin e mëposhtëm:

2.1Të pakësohen shpenzimet :

Në lekë

Strukturat	Programet	Kod Produkti	Kap	231 (investime)	Pershkrim
MNZ	AE135	P328AAA	01	4136000	Blerje mjeti zjarrfikës

2.2Të shtohen shpenzimet:

Në lekë

Strukturat	Programet	Kod Produkti	Kap	600 (paga)	601 (sigurime)	606 (transferta tek individe)	Pershkrim
MNZ	AE135	V328AAA	01	1200000	536000	2400000	Paga ,sigurime dhe psherblim per punonjesit

Pas miratimit në këshill të zërit për lidhje energjie për Pallatin e Sportit ,ky zë u realizua dhe diferencën e fondit kërkojmë ta rishpërndajmë për diferencat në fond page dhe sigurime për projektet RIWET dhe Key people.Pasi për projektin RIËET nuk është rarifikuar ende marrëveshja financiare nga Sheti Shqiptar dhe për këtë arsye donatori nuk na ka kaluar ende fondet. Për projektin Key people kishte një diferencë të vogël në planifikim.

3.1Të pakësohen shpenzimet :

Strukturat	Programi	Kod Produkti	Kap	602 (shpenzime operative)	Përshkrim
Sporti	AD135	V813AAB	05	331000	Lidhje energjie dhe blerje materiale të nevojshme për realizimin e lidhjes për Pallatin e sportit

3.2Të shtohen shpenzimet :

Strukturat	Programi	Kod Produkti	Kap	600 (paga)	601 (sigurime)	602 (shpenzime operative)	Pershkrim
Perfshirja sociale	AC135	V043AAA	05	252000	79000		Projekti RIWET dhe Key people

Për arsye procedurash fondet që presim nga projekti URBACT nuk janë transferuar në kohë dhe ka lindur nevoja për parashikim fondesh për paga e sigurime për këtë projekt. Nga analiza 8-mujore u vu re se për shkak të komponentit të vjetërsisë së pagës nevojiten fonde shtesë për paga e sigurime të kultura. Një kërkesë shtesë është dhe realizimi i pikës së lidhjes të biblioteka e qytetit . Fondet për realizimin e këtyre shpenzimeve sygjerojmë të përballohen nga zëri i Maratonës së Këngës Popullore që kishim planifikuar sëbashku pasi ky aktivitet u mundësua i gjithi me donacione.

4.1Të pakësohen shpenzimet :

Strukturat	Programi	Kod Produkti	Kap	602 (shpenzime operative)	Përshkrim
Kultura	AD135	V822AAA	05	500000	Maratona e Kenges popullore

4.2Të shtohen shpenzimet :

Strukturat	Programi	Kod Produkti	Kap	600 (paga)	601(sigurime)	602(shpenzime operative)	Përshkrim
Kultura	AD135	V822AAA	05	190000	210000	100000	Paga e sigurime Kultura dhe Urbact Pike lidhje Biblioteka

Ju faleminderit !

KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PËRMET

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ Datë _____ 2025

PËR

**MBLEDHJEN E DETYRIMEVE TATIMORE VJETORE DHE DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURATË
SUBJEKTEVE DEBITORË, ME AGJENTIN TATIMOR SHOQËRINË E UJËSJELLËS KANALIZIMEVE
GJIROKASTËR.**

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurta Tatimore në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimi nr.24, datë 02.09.2008 "Për procedurta Tatimore ", kreu XI "Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor" dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të bëhet mbledhja e detyrimeve tatimore vjetore dhe detyrimeve të prapambetura të subjekteve debitorë, me Agjentin Tatimor Shoqërinë e Ujësjiellës Kanalizimeve Gjirokastrë.
2. Kryetari i Bashkisë të nënshkruaj Akt – Marrveshje me Shoqërinë e Ujësjiellës Kanalizimeve Gjirokastrë, për hapat që do të ndiqen për mbledhjen e detyrimit Tatimor.
3. Detyrimi i Vitit 2025, do të faturohet në faturën e muajit aktual pas konfirmimit të vendimit në Prefekturën Gjirokastrë, sipas listave bashklidhur.
4. Detyrimet e prapambetura do të ndahen me këste për likuidim sipas akt-marrveshjeve me subjektet debitorë sipas listave bashklidhur.
5. Në rastin kur subjekti nuk paraqitet për lidhjen e akt-marrveshjes me këste, për detyrimin tatimor, nga ana e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik do të aplikohet vet ndarja me këste deri në shlyerjen e vlerës së detyrimit, në të njëjtën mënyrë si dhe për subjektet që do të lidhin Akt-Marrveshje.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Taksave, Aseteve dhe licencave.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA

Alma

Hoxha

Digitally signed by
Alma Hoxha
Date: 2025.09.17
09:57:03 +0200

Sheshi "Abdyl Frashëri", tel.+35581322254, e-mail: info@bashkiapermet.gov.al



RELACION



Sektori i Tatim Taksave Aseteve dhe Licencave bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr.9920,datë 19.05.2008"Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë",Udhëzimi nr.24,datë 02.09.2008 "Për procedurta Tatimore "kreu XI "Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor",ka bërë njoftime,rinjoftime për të gjithë subjektet debitorë ndër vite,konkretisht me shkresat nr.532 Datë 25.02.2025,shkresa nr.1641 datë 26.05.2025,shkresa nr.2807,datë 02.09.2025 dhe përsëri nuk ka pasur reagim nga subjektet që figurojnë debitorë ndër vite.

Vlera e debisë nga viti 2015 deri në vitin 2024 shkon 29 257 882 lekë.Gjatë vitit 2025 vlera e debisë llogaritet 5 869 267 lekë.Detyrime të prapambetura janë derdhura nga rreth 25 subjekte,në vlerën 1,193,018lekë. Ngelen debitorë dhe shumë subjekte të tjerë të cilët në të shumtën e rasteve kanë refuzuar marrjen e zarfit për tu njohur me borxhin tatimor që i kanë krijuar bashkisë për të ardhurat vendore .

U është nisur shkresë të gjitha institucioneve bankare si dhe Bankës së Shqipërisë për të na informuar nëse subjektet debitorë kanë llogari bankare pranë institucioneve të tyre .

Të ndodhur para një fakti të tillë,kur vit pas viti bëhen njoftime,rinjoftime,blokohe llogari për shumë pak persona që kanë llogari bankare ,menduar të hedhim një hap tjetër,sigurisht kjo e lidhur me vendimarrjen tuaj,vjeljen e detyrimeve vendore të prapambetura nëpërmjet Agjentit Tatimor Shoqërisë së Ujësjetës Kanalizimeve Gjirokastrë.

Mendojmë që menjëherë pas konfirmimit të këtij akti në Prefekturën Gjirokastrë ,të ngarkohet në faturën mujore detyrimi i vitit aktual 2025,për të gjitha subjektet me debi të mbartura nga vitet e mëparëshme,themi detyrimi për arsye se vjelja e taksave dhe tarifave vendore duhet të ishte bërë brenda datës 30 Prill 2025.

Hapi tjetër që do të ndërmerim është faturimi i debisë së ngelur,më këste,kjo për të mos rënduar subjektet,sigurisht dhe këtë hap do ta ndjekim duke u dakordësuar me anë të një Akt -Marveshje midis Sektorit përkatës për taksat dhe subjektit debitor.

Njëkohësisht edhe për subjektet që nuk do të paraqiten për lidhje të Akt-Marrveshjes për ndarje me këste nga ana e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik do të aplikohet vet ndarja me këste deri në shlyerjen e vlerës së detyrimit,në të njëjtën mënyrë si dhe për subjektet që do të lidhin Akt-Marrveshje.

Shpresojmë në mirëkuptimin tuaj në marrjen e një vendimi të tillë.

Mendojmë që kjo mund të jetë rruga e vetme për uljen e borxhit tatimor,rritjen e performancës së institucionit,njëkohësisht më shumë të ardhura për të bërë punë më të mira në komunitet dhe besojmë se kështu do ti trajtojmë në mënyrë të barabartë të gjithë subjektet që operojnë në qytet dhe Njësitë Administrative .

Konceptoi :Përgjegjësi i Sektorit të Taksave Dorjan Metko

Miratoi :Drejtori i Zhvillimit Ekonomik Etleva Myftari



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr. datë _____.____.2025

**PËR
PËRDORIMIN E FONDIT PËR EMERGJENCAT CIVILE**

Në mbledhjen e datës _____.____.2025, mbështetur në: Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 4 dhe 24, Ligjin Nr.68, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjin Nr.115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, VKB Nr.107, datë 18.12.2024, “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Përmet, viti 2025”, Ligjin Nr.45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, VKM Nr.414, datë 08.07.2021, “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, Shkresën nr.1949, datë 12.11.2024, të Repartit Ushtarak Nr.4040 (Xhenio), “Për vlerësimin e situatës në masivin shkëmbor në fshatin Petran, Bashkia Përmet”

V E N D O S I :

1. Të miratojë përdorimin e fondit për shpenzime udhëtimi dhe dieta të forcave xheniere për kryerjen e ndërhyrjes speciale për prishjen e masiveve shkëmbore në fshatin Petran (Petran i Vjetër), në vlerën 533 000 (pesëqind e tridhjetë e tre mijë) lekë.
2. Fondet për mbulimin e këtyre shpenzimeve do të përballohen nga struktura buxhetore: 17.01.10910.604.91707AG, në vlerën 533 000 lekë.
3. Sasia prej 930 (nëntëqind e tridhjetë) litrash karburant do të mbulohet nga struktura buxhetore: 00.AF135, KAP 1, 602, Kod Produkti V328AAC, e parashikuar në Buxhetin e Bashkisë Përmet.
4. Baza materiale për zërat e mëposhtëm do të mbulohet nga gjendja aktuale e magazinës:

Nr.	Emërtimi i zërit të punës	Njësia	Sasia
1	Lubrifikant	litra	20
3	Karburant	litra	930

1. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhet-Finances dhe Sektori i Mbrojtjes Civile.
2. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA
Alma

Digitally signed by Alma
Hoxha
Date: 2025.07.09 10:08:12

Sheshi “Abdyl Frashëri”, tel.+35581322254, web: www.bashkiapermet.gov.al, e-mail: info@bashkiapermet.gov.al





RELACION
PËR
PËRDORIMIN E FONDIT PËR EMERGJENCAT CIVILE
*(Për neutralizim të shkëmbinjve në fshatin Petran (Petran i Vjetër),
Njësia Administrative Petran, bashkia Përmet)*

Në zbatim të 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", Ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 "Per Mbrojtjen Civile", shkresës së Kryetarit të bashkisë drejtuar Ministrit të Mbrojtjes me nr 2985, date 07.11.2023 "Kërkesë me specialist xhenier dhe mjete për neutralizimin e masiveve shkëmbore" si dhe korenspondencës me Repartin Ushtarak Nr. 4040 (Xhenjo). ju informojmë se:

Në datën 22 Tetor 2024 me shkresë Nr 2766. Prot, bashkia Përmet i është drejtuar për mbështetje Ministrisë së Mbrojtjes për neutralizimin e masiveve shkëmbore në fshatin Petran (Petran i Vjetër). Duke parë situatën nga ana e Bashkisë është kërkuar vlerësim i specializuar nga ana e forcave të xhenjos. Një ekip xhenier prej 4 (katër) forcash, zhvilluan përnjohjen për vlerësimin e situatës në masivin shkëmbor për mundësitë së shpërthimit të komanduar shkëmbinjve në fshatin Petran (Petran i Vjetër), Njësia Administrative Petran, bashkia Përmet.

Nga kontrolli, verifikimi, këqyrja e masivit shkëmbor rezulton se sipërfaqja totale e masivit shkëmbor është përafërsisht 80 m² dhe në të gjendet një sasi prej 3 copë shkëmbinjsh me volum të përgjithshëm rreth 2 m³ me tendencë rënie në drejtim të banesave (shtëpive) dhe rrugës së fshatit.

Situata është emergjente duhet ndërhyhet sa më shpejt pasi shirat e stinës se dimrit, mund të sjellin rrëshqitje të tjera gurësh dhe mund te kete premisa për ngjarje te jashtëzakonshme.

Batalioni i xhenios ka kapacitete në personel, teknike dhe baze materiale për eliminimin e situatës së shkaktuar. Operacioni special xhenier do te kryhet sipas një plani operacional dhe një plani bashkëpunimi me bashkinë Përmet. Eliminimi i problematikës, prishja e kontrolluar e shkëmbinjve do të kryhet e kombinuar me prishje mekanike me matrapik dhe goditje me eksplozive të shkëmbinjve duke marrë masa paraprake të forta sigurie ndërtimi i pengesave të përforcuar me rrjet teli, profile metalike të përforcuara me saldim.

Afati i kryerjes së operacionit të jetë 8 ditë.

Disa prej zërave dhe volumeve kryesore të punës që do të kryhen janë:

Hapje gropash me krahe dhe matrapik për vendosjen e shtyllave për rrjetën e telit.

Ndërtim pengesash për mbrotjen e pronave me rrejt teli dhe shtylla hekuri.

Hapje furnelash me pistoletë shpimi (gjatësi të ndryshme) 120 copë

Hapje gropash me matrapik 10 copë

Hapje gropash (fugash) me krahë 5 copë

Armatosje fugasesh (vendosje LP, FD, taposje) 120 copë

Ndërtim rrjeti fitil detonant (sipas planit)

Përgatitje ngarkesash të përqendruara (fugase) me LP (sipas planit)

Shkatërrim shkëmbi me mina 50 m³

Shkatërrim shkëmbi me matrapik 20 m³

Skarifikim shkëmbi me krahë 30 m³



Municione xheniere për shkatërrimin e masiveve shkëmbore

Lëndë plasëse plastike	7 kg
Fitil detonant	350 ml
Fitil zjarrpërciellës	50 ml
Kapsolla detonatore	20 copë

Kostoja e përafërt e operacionit është:

karburant: 930 litra (Emergjencat Civile)

lubrifikant: 20 litra (gjendja aktuale e magazinës)

trajtim personeli: 12 veta x 8 ditë x 5500 lekë/person 528.000 lekë

kosto shtesë: 5000 lekë

Kostoja e përafërt e operacionit: 533.000 lekë.

Bashkia Përmet merë përsipër:

- Personel sigurie (polic) për sigurimin e personelit dhe teknikës gjatë zhvillimit të operacionit, si dhe shoqërimit të municionit xhenier
- Ruajtja e municionit xhenier në ambient të survejuar me kamera dhe polici
- Këqyrjen e operacionit me 1 person.
- Mbështetja me mjek/ndihmës mjek dhe mjet, ambulancë gjatë zhvillimit të operacionit
- Sigurimi i bazës materiale pas zhvillimit të operacionit..
- Largimin e banorëve në momentin e kryerjes së shpërthimit.
- Ndërpërjetjen e energjisë elektrike në momentin e shpërthimit.
- Njoftimin e institucioneve, OSHEE, NJVKSH, Spitali Përmet, Komisariati i Policisë Përmet,etj.

Pas miratimit të këtij projekt vendimi bashkia merr përsipër shpenzimet e operacionit në vlerën 533.000 lekë.

Persa i perket zerave

- Karburant do te mbulohet nga sasia qe bashkia ka aktualisht ne strukturen e Emergjencave Civile.

- Lubrifikant do te mbulohet nga gjendja aktuale ne magazine.

Ju faleminderit!

Për Struktura e Emergjencave Civile
Bekim Mecani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr ____ Prot

Përmet, më ____ / ____ 2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____, Datë, ____ 2025

PER

NJË NDRYSHIM NË VKM NR.398 DATË 13.05.2025 2016 “PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKIVE, TË PYJEVE DHE KULLOTAVE PUBLIKE”, NDRYSHUAR ME VKM NR.467, DT.31.07.2025” PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË PËRDORIMIT TË KULLOTAVE DHE LIVADHEVE PËR KULLOTJE OSE KOSITJE, PËR VEPRIMTARI SHOQËRORE, SHËNDETËSORE, SPORTIVE E TURISTIKE DHE PËR PRODHIMIN E ENERGJISË SË RINOVUESHME”.

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për Qeverisjen vendore”, Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”, ligji 9693”Për fondin kullosor”, ndryshuar në Ligj Nr.49/2016 VKM nr.433 dt.08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike”, i ndryshuar në VKM nr.398.dt 13.05.2025, VKM nr.467, dt.31.07.2025” Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme”, me propozim të kryetarit të Bashkisë, bazuar në relacionin e paraqitur nga Sektori Bujqësi-Turizëm. Këshilli i Bashkisë Përmet, në mbledhjen e datës _____,

VENDOSI

1. Miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve, për kullotjen e bagëtive ose për kositje të barit dhe për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
2. Tarifat për dhënjë në përdorim të kullotave dhe livadheve për kullotjen e bagëtive ose për kositjen e barit janë sipas tabelës numër 1.

Tabela Nr 1: Tarifat për dhënjë në përdorim të kullotave e livadheve për kullotjen e bagëtive ose për kositjen e barit.

Kullotje	Lloji I bagëtive	Tipi I kullotës	
		Dimërore Lekë/krerë/vit	Verore Lekë/krerë/vit
1	Dhen	200	200
2	Dhi	250	250
3	Gjedhë	1000	1000
4	njëthundrakë	1200	1200
Kositje bari		Dimërore lekë/m ²	Verore lekë/m ²
			2
Ndërtime			
1	Qendër stani e rrethuar	100	100
2	Qendër përpunimi bulmeti	150	150

3	Ngrehinë banimi për barinjtë	50	50
4	Objekte ndihmëse për barinjtë	150	150

3. Tarifat për dhënjë në përdorim të kullotave dhe livadheve ,për veprimtari shoqërore,shëndetësore,sportive e turistike,janë sipas tabelës numër 2.

Tabela Nr.2:Tarifat për dhënjë në përdorim të kullotave dhe livadheve për veprimtari shoqërore,shëndetësore,sportive e turistike.

Aktiviteti	Tarifa lekë/ha/vit		
	Për 1 vit	2-5 vjet	6-10vjet
Ndërtim Agroturistik	100 000	80000	65000
Veprimtari sportive	140000	100000	85000
Veprimtari çlodhëse dhe kampingje	100000	85000	65000

4. Tarifat për dhënjë në përdorim të kullotave dhe livadheve për prodhimin e energjisë së rinovueshme janë sipas tabelës numër 3.

Tarifat për dhënjë në përdorim të kullotave dhe livadheve për prodhimin e energjisë së rinovueshme.

Aktiviteti	Sipërfaqja(ha)	Kohëzgjatja(vjet)	Tarifa(lekë/vit)
Park fotovoltai	Deri në 10	Deri në 10	192000
		Mbi 10	173000
	Mbi 10	Deri në 10	156000
		Mbi 10	132000
Vendosje aerogjeneratorë	Deri në 10	Deri në 10	120000
		Mbi 10	100000
	Mbi 10	Deri në 10	90000
		Mbi 10	70000

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike,Spektori Bujësi-Turizëm,Spektori Pyje-Kullota.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës, të nenit 55,të Ligjit nr.139/2015”Për Vetëqeverisjen Vendore.

KRYETAR I BASHKISË

Alma Hoxha
Alma
Hoxha

Digitally signed by Alma Hoxha
Date: 2025.09.17 10:11:31 +0200

RELACION



Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për Qeverisjen vendore”, Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”, ligji 9693”Për fondin kullosor”,ndryshuar në Ligj Nr.49/2016VKM nr.433 dt.08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike”, i ndryshuar në VKM nr.398.dt 13.05.2025,VKM nr.467,dt31.07.2025”Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje,për veprimtari shoqërore,shëndetësore,sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme”.

I. Qëllimi

Ky relacion paraqitet në Këshillit Bashkiak me qëllim miratimin e tarifave për shfrytëzimin e kullotave publike në territorin e bashkisë, në përputhje me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe legjislacionin për përdorimin dhe administrimin e kullotave.

II. Arsyetimi

1. **Nevoja për rregullim** – Në territorin e bashkisë ka sipërfaqe të konsiderueshme kullotash të cilat përdoren nga blegtorët vendas dhe të rretheve të tjera. Përdorimi i tyre kërkon një sistem të drejtë dhe transparent tarifash, për të garantuar:
 - o mirëmbajtjen dhe ruajtjen e kullotave;
 - o përdorim të qëndrueshëm të resurseve natyrore;
 - o të ardhura në buxhetin vendor.
2. **Baza ligjore** – Bashkia, përmes Këshillit Bashkiak, ka të drejtë të miratojë tarifatat vendore, përfshirë edhe ato që lidhen me shfrytëzimin e kullotave.
3. **Interesi publik** – Vendosja e tarifave ndihmon në krijimin e barazisë mes përdoruesve dhe në përmirësimin e menaxhimit të territorit rural.

III. Propozimi

Propozohet që të miratohen këto tarifa orientuese për përdorimin e kullotave, Tarifat të cilat janë paraqitur më poshtë sipas Vendimit numër 467,datë 31.07.2025 të Këshillit të Ministrave,” Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje,për veprimtari shoqërore,shëndetësore,sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme.gjithashtu,krahas tyr e janë paraqitur tarifatat e mëparshme sipas VKM Nr.632,datë11.06.2009,tashmë e shfuqizuar.

Pjesë e këtij propozimi janë dhe tarifatat për aktivitete të tjer si veprimtari shoqërore,shëndetësore,sportive e turistike sidhe prodhimin e energjisë së rinovueshme,aktivitete të cilat mungonin në vendimin e mëparshëm.

- 1.Tarifatat për dhënjën në përdorim të kullotave e livadheve për kullotjen e bagëtive ose për kositjen e barit.

RELACION



Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për Qeverisjen vendore”, Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”, ligji 9693”Për fondin kulosor”,ndryshuar në Ligj Nr.49/2016VKM nr.433 dt.08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike”, i ndryshuar në VKM nr.398.dt 13.05.2025,VKM nr.467,dt31.07.2025”Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje,për veprimtari shoqërore,shëndetësore,sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme”.

I. Qëllimi

Ky relacion paraqitet në Këshillit Bashkiak me qëllim miratimin e tarifave për shfrytëzimin e kullotave publike në territorin e bashkisë, në përputhje me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe legjislacionin për përdorimin dhe administrimin e kullotave.

II. Arsyetimi

1. **Nevoja për rregullim** – Në territorin e bashkisë ka sipërfaqe të konsiderueshme kullotash të cilat përdoren nga blegtorët vendas dhe të rretheve të tjera. Përdorimi i tyre kërkon një sistem të drejtë dhe transparent tarifash, për të garantuar:
 - o mirëmbajtjen dhe ruajtjen e kullotave;
 - o përdorim të qëndrueshëm të resurseve natyrore;
 - o të ardhura në buxhetin vendor.
2. **Baza ligjore** – Bashkia, përmes Këshillit Bashkiak, ka të drejtë të miratojë tarifatat vendore, përfshirë edhe ato që lidhen me shfrytëzimin e kullotave.
3. **Interesi publik** – Vendorsja e tarifave ndihmon në krijimin e barazisë mes përdoruesve dhe në përmirësimin e menaxhimit të territorit rural.

III. Propozimi

Propozohet që të miratohen këto tarifa orientuese për përdorimin e kullotave, Tarifatat të cilat janë paraqitur më poshtë sipas Vendimit numër 467,datë 31.07.2025 të Këshillit të Ministrave,” Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje,për veprimtari shoqërore,shëndetësore,sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme.gjithashtu,krahas tyre janë paraqitur tarifatat e mëparshme sipas VKM Nr.632,datë11.06.2009,tashmë e shfuqizuar.

Pjesë e këtij propozimi janë dhe tarifatat për aktivitete të tjera si veprimtari shoqërore,shëndetësore,sportive e turistike sidhe prodhimin e energjisë së rinovueshme,aktivitete të cilat mungonin në vendimin e mëparshëm.

- 1.Tarifatat për dhënjën në përdorim të kullotave e livadheve për kullotjen e bagëtive ose për kositjen e barit.



Kullotje	Lloji i bagëtime	Tipi i kullotës			
		Dimërore Lekë/krerë/vit		Verore Lekë/krerë/vit	
		ishte	është	ishte	është
1	Dhen	100	200	100	200
2	Dhi	100	250	80	250
3	Gjedhë	800	1000	800	1000
4	njëthundrakë	800	12000	800	1200
Kositje bari		Dimërore lekë/m ²		Verore lekë/m ²	
		ishte	është	ishte	është
				1	2
Ndërtime					
1	Qendër stani e rrethuar	50	100	50	100
2	Qendër përpunimi bulmeti	100	150	100	150
3	Ngrehinë banimi për barinjte	50	50	50	50
4	Objekte ndihmëse për barinjte	100	150	100	150

2.Tarifat për dhënjën në përdorim të kullotave dhe livadheve për veprimtari shoqërore,shëndetësore,sportive e turistike.

Aktiviteti	Tarifa lekë/ha/vit		
	Për 1 vit	2-5 vjet	6-10vjet
Ndërtime Agroturistike	100 000	80000	65000
Veprimtari sportive	140000	100000	85000
Veprimtari çlodhëse dhe kampingje	100000	85000	65000

3.Tarifat për dhënjë në përdorim të kullotave dhe livadheve për prodhimin e energjisë së rinovueshme.

Aktiviteti	Sipërfsqia(ha)	Kohëzgjatja(vjet)	Tarifa(lekë/vit)
Park fotovoltaik	Deri në 10	Deri në 10	192000
		Mbi 10	173000
	Mbi 10	Deri në 10	156000
		Mbi 10	132000
Vendosje aerogjeneratorë	Deri në 10	Deri në 10	120000
		Mbi 10	100000
	Mbi 10	Deri në 10	90000
		Mbi 10	70000

IV. Përfitimet

- Sigurimi i të ardhurave shtesë për buxhetin vendor;
- Mundësia për të investuar në infrastrukturën rurale dhe përmirësimin e kullotave;
- Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore;
- Mbështetje për zhvillimin e blegtorisë lokale.



V. Përfundimi

Në bazë të argumenteve të mësipërme, i propozohet Këshillit Bashkiak të miratojë tarifën e përdorimit të kullotave në territorin e bashkisë, duke i përcaktuar ato në vendimin përkatës.

Përgjegjësi i Sektorit
Ing. Bledar Tesho



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PËRMET

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ Datë _____ 2025

PËR

MIRATIMIN E STRATEGJISË SË PLANIT TË VEPRIMIT TË TURIZMIT
2025-2030, BASHKIA PËRMET.

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligji Nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", Ligji Nr. 93/20215 "Për Turizmin" i ndryshuar, VKM Nr. 711/dt. 12.10.2016 Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret për projektimin e strukturave akomoduese", Vendimi Nr. 22/dt. 12.01.2018 "Për miratimin e kriterëve për Çertifikimin e veprimtarisë së agroturizmit", VKM nr. 466, datë 31.07.2025, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit 2025-2030 dhe planit të veprimit "dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë

VENDOSI:

1. Të miratohet Strategjia e Planit të Veprimit të turizmit 2025-2030, Bashkia Përmët.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Bujqësisë dhe Turizmit, Drejtoria e Financës, burimeve njerëzore dhe shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Projekteve dhe Integritimit Evropian si dhe të gjitha drejtorit dhe sektorët që janë pjesë e këtij plani strategjik.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET**

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ Datë _____ 2025

PËR

**“MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET BASHKISË
PËRMET DHE SHOQATËS KOMBËTARE TË BASHKIVE TË SHQIPËRISË PËR
PAGESËN E KUOTËS SË ANËTARËSISË ,SI DHE DHËNIEN E AUTORIZIMIT TË
KRYETARIT TË BASHKISË PËR NËNSHKRIMIN E SAJ”**

